



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr. 03-315
25.09.2023
Shkup

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 92, paragrafët (1) dhe (3) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022 Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-3334/1 datë 1.9.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3506/6 datë 25.9.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 30-të mbajtur më 22.9.2023 miratoi si në vijon:

Aktvendim
për ndërmarrje të masës - paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles, për shkelje të kryer të nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), të mënyrës që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 8 gusht 2023, nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar fillimisht(burimor) si vepra audiovizuale maqedonase dhe as të paktën gjysmën e minimumit ligjor program i krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, transmetuar në periudhën nga ora 7:00 deri në orën 19:00.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3334/1 datë 1.9.2023, i cili është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr. 1.

2. OBLIGOHET SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles, që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Vendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, Agjencia është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të radiodifuzerëve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik në drejtim (aspek) të respektimit të dispozitave nga Ligji i

cituar, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në përputhje me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë - vërejtje publike në rastet kur është kryer shkelje ose cënim (kundërvajtje) të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve përcaktuar me lejen dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me neni 92, paragrafët 1 dhe 3 të LSHMAAV, Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbim programor televiziv janë të detyruara të transmetojnë së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audio ose audiovizuale maqedonase, ndërsa shërbimi publik radiodifuziv së paku 40%. Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbim programor televiziv janë të detyruara të përmbushin së paku gjysmën e detyrimeve të përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni në periudhën prej orës 07:00 deri në ora 19:00.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 31 gusht 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore, nga ku u konstatua se më 8 gusht 2023, shërbimi programor televiziv i SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP Veles, ka transmetuar 5 orë 36 minuta e 35 sekonda programi të krijuar burimor (fillimisht)si vepra audiovizuale maqedonase, që është 26,17% e totalit të programit të transmetuar gjatë ditës që përfshihet në llogaritjen për program të krijuar burimor (21 orë 26 minuta dhe 13 sekonda). Minimumi Ligjor prej 30% për transmetimin e programi të krijuar burimor gjatë një dite, në raport me totalin e programit të transmetuar më 8 gusht që hyn në llogaritjen për program të krijuar burimor (21 : 26 : 13) është 6 orë 25 minuta dhe 51 sekonda. SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles, ka transmetuar për 49 minuta e 16 sekonda më pak program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase.

Gjysma e minimumit ligjor (nga 06 : 25 : 51) është 3 orë 12 minuta e 55 sekonda program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, shuma minimale që duhej të transmetohej në programin e SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles, në periudhën nga ora 7:00 deri në orën 19:00. Gjatë kësaj periudhe, siç u konstatua nga mbikëqyrja, janë transmetuar 3 orë e 20 sekonda programe të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, që në këtë situatë është për 12 minuta e 35 sekonda më pak se minimumi i kërkuar.

Shkelja nga pika 1 e këtij aktvendimi është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3334/1 datë 1.9.2023, e cila është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles, më 1.9.2023, dërgoi Shkresë ark.nr.10-3334/2 datë 1.9.2023, me të cilën i ka dorëzuar Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-3334/1 datë 1.9.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, t'i dorëzojë Këshillit të Agjencisë deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga ana e transmetuesit më 4.9.2023. Në afatin e paraparë SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin SHPKNJP, Veles, nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të Ligjit. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 22.9.2023, shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles, t'i shqiptoi masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 92, paragrafët (1) dhe (3) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-3334/1 datë 1.9.2023, për shkak të konstatimit të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 30-të mbajtur më 22.9.2023, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-3506/6 datë 25.9.2023, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles dhe obligohet, që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24, paragrafët (1) dhe (2) të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër tij radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ praqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-3334/1 datë 1.9.2023 .

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.